

VENDIM
Nr. 277, datë 1.4.2015

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOZHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 3 035.6 M², BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 90, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-SË)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË

(ndryshuar me vendimin nr. 198, datë 4.3.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-vjeçare, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 (tre mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtë) m², brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (Ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për *përdorimin për zyra për administratën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe për institucionet e varësisë*, sipas ndarjes që do të përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ndalohet të ndryshojë destinacionin e objekteve dhe të sipërfaqes së truallit funksional, të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJA E PRONES Nr.90 REP. USHT. 4400 (ISH SHTABI I K. M. L.) TIRANE






SIP. ME NDERTIME =1402.3 m2

SHENIM: -Kjo planvendosje u hartua bazuar ne kerkesene DMA-se ne faks mesazhin e dt. 24.03.2015 mbi planvendosjen e punuar ne Janar 2012, e marre ne arkhivin e IGJII-s


$$\begin{array}{r} 4 \overline{) 581} \\ \underline{200} \end{array}$$

Topog. Selman . Lleshi

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE /eripunu




Kati perdhe sip.611 m2



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

/e ripunuar/




E PARE SHK 1:100

Kati i pare sip. 611 m²



(e ripunuar)



YTE shk 1:100

Kati i dyte sip.611 m2

